

# WINTERWERP kundër HOLLANDËS

(kërkesa nr. 6301/73)

24 tetor 1979

*kjo çështje ka të bëjë me rishikimin periodik të ligjshmërisë së heqjes së lirisë së një personi, në këtë rast të mbyllur në një spital psikiatrik*

## I. Faktet kryesore

1. Në maj 1968, me anë të një procedure të përshpejtuar nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë së Amersfoort, z. Winterwerp u shtrua në një spital

psikiatrik për tre jave. Afati i shtrimit të tij u zgjat nga prokuroria. Ne qershor, me kërkesën e bashkëshortes së tij, gjykata e rrethit lëshoi një urdhër e përkohshëm që autorizonte mbajtjen e tij të mbyllur të detyrueshme për gjashtë muaj. Me kërkesën e mëtejshme të së shoqes dhe më pas me kërkesën e prokurorisë, çdo vit Gjykata Rajonale lëshonte urdhrat e izolimit.

2. Para se të lëshoheshin urdhrat e ndryshëm, z. Winterwerp nuk ishte njoftuar se procedurat për lëshimin e tyre ishin në zhvillim e sipër. Atij nuk iu dha kurrë rasti që, personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi të tij, të mbronte çështjen e tij përpara gjykatave ose të kundërshtonte diagnozat mjekësore në të cilat ishin bazuar gjykatat për të dhënë vendimin.

3. Z. Winterwerp kërkoi katër herë nxjerrjen e tij nga spitali. Në vitin 1969, gjykata rajonale, pasi dëgjoji pacientin, e hodhi poshtë kërkesën. Në vitet 1971, 1972, dhe 1973 prokurori, e rrëzoi kërkesën si pa asnjë mundësi për të qenë e suksesshme, por pa ia paraqitur atë gjykatës rajonale për marrjen e një vendimi. Nga ana tjetër duke qenë i mbyllur në një spital psikiatrik Z. Winterwerp automatikisht humbi të drejtën për të administruar pasurinë e tij. Pasuria e tij u vu nën administrimin e një tutori të emëruar nga gjykata rajonale në vitin 1971.

4. Kërkesa e Z. Winterwerp u paraqit përpara Komisionit më 13 dhjetor 1972 dhe u pranua më 30 shtator 1975. Në raportin e tij hartuar në 15 dhjetor 1977, Komisioni u shpreh njëzëri, se bëhej fjalë për një shkelje të nenit 5 § 4, por jo nenit 5 § 1. Komisioni vlerësoi se, duke parë rrethanat e veçanta, ai nuk mund të shprehte asnjë pikëpamje mbi shkeljen e pretenduar të nenit 6 § 1. Komisioni ia paraqiti çështjen për shqyrtim Gjykatës, më 9 mars 1978, kurse qeveria Holandeze ia paraqiti në 21 prill 1978.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1

5. Vendimi fillon me shqyrtimin e çështjes se cilat nga kërkesat përfshihen në shprehjen "burgim i ligjshëm i personave mendërisht të sëmurë", neni 5 § 1 (e). Është theksuar se Konventa nuk lejon izolimin e një individi thjesht sepse opinionet ose sjelljet e tij devijojnë nga rregullat që udhëheqin një shoqëri të caktuar. Me një fjalë, Gjykata arriti në përfundimin se një çrregullim mendor i vërtetë duhet të vërtetohet në mënyrë të besueshme përpara autoriteteve vendase mbi bazat e ekspertizave mjekësore të paanshme, çrregullimi duhet të jetë i një niveli të tillë që nevojitet izolimin e detyrueshëm dhe vlefshmëria e mbikëqyrjes së vazhdueshme varet nga kohëzgjatja e këtij çrregullimi. Duke u bazuar mbi faktet, Gjykata vlerësoi se izolimi i Z. Winterwerp, gjatë gjithë atyre fazave, parashikohej nga rregulli i pikës (e).

6. Vendimi vijon më pas me shqyrtimin e problemit nëse Z. Winterwerp është burgosur sipas procedurave të parashikuara me ligj: këto fjalë i referohen në thelb legjislacionit vendas, por ky i fundit duhet të përputhet

me Konventën, përfshirë këtu edhe parimet e përgjithshme të shprehura ose që rrjedhin prej saj. Sipas Gjykatës, asgjë nuk vërteton se procedura e parashikuar nga ligji holandez nuk është respektuar.

7. Së fundi, vendimi shpreh se e drejta e një të sëmuri për një trajtim të përshtatshëm me gjendjen e tij nuk parashikohet nga neni 5 § 1 (e). Gjykata arriti në përfundimin se neni 5 § 1 nuk është shkelur.

#### **B. Në lidhje me nenin 5 § 4**

8. Problemi tjetër që lindi lidhur me nenin 5 § 4, ishte nëse procedurat e zbatuara në çështjen Winterwerp i siguronin kërkuesit garancinë për t'iu drejtuar një gjykate e cila do të vendoste mbi ligjshmërinë e burgimit të tij.

9. Përsa i përket periudhës fillestare të paraburgimit të vendosur nga një procedurë urgjente, as kryetari i bashkisë, as prokurori nuk mund të konsideroheshin sikur mishëronin karakteristikat e një "gjykate" përse u përket vendimeve ose autorizimeve të izolimit të Z. Winterwerp. Në të kundërt, gjykata e rrethit dhe gjykata rajonale përbënin një gjykatë sipas kuptimit organik të fjalës. Megjithatë, neni 5 § 4 kërkon që procedurat përkatëse të shoqërohen me garanci themelore. Pra është e domosdoshme që individ i izoluar të gëzojë të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate si edhe të drejtën për t'u dëgjuar prej saj ose në rast nevojë për t'u përfaqësuar para saj. Këto garanci themelore munguan në rastin e Z. Winterwerp në procedurën e ndjekur nga gjykatat e rrethit dhe të rajonit.

10. Në kërkesën e tij të parë për shfajësim, të interesuarit i janë siguruar të gjitha garancitë e parashikuara nga neni 5 § 4, por tre kërkesat e fundit të tij të hedhura poshtë nga prokurori, nuk u morën në shqyrtim nga gjykata. Gjykata vendosi njëzëri se neni 5 § 4 ishte shkelur.

#### **C. Në lidhje me nenin 6 paragrafi 1**

11. Gjykata çmoi se ajo kishte kompetencë për t'u shprehur mbi kërkesën e bazuar në nenin 6 § 1, edhe pse Z. Winterwerp nuk kishte bërë ndonjë ankesë në lidhje me këtë nen, në kërkesën e paraqitur përpara Komisionit në dhjetor 1972.

12. Ajo vlerësoi më pas se duke e privuar kërkuesin nga e drejta për të administruar pasurinë e tij do të thoshte të vendosje për të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil duke mos i siguruar atij garancitë e parashikuara nga neni 6 § 1, të përmbledhura në formulën "e drejta për t'iu drejtuar një gjykate". Sipas mendimit unanim të Gjykatës kjo klauzolë është shkelur.

#### **D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

13. Avokati i kërkuesit sugjeronte për të arritur një kënaqje të drejtë, një program që konsistonte kryesisht në sigurimin e një kurimi të mëtejshëm me të gjitha garancitë procedurale përse i përket lëshimit të autorizimeve vjetore të izolimit dhe shqyrtimin e kërkesave për shfajësim. Gjykata e rezervoi këtë problem dhe ftoi Komisionin për të dhënë vëzhgimet e tij brenda një afati prej dy muajsh si edhe të njoftojë Gjykatën për ndonjë marrëveshje të arritur midis qeverisë dhe kërkuesit.

### III. Koment

14. Me vendimin e dhënë në lidhje me këtë çështje Gjykata ngre në parim jurisprudencial një element të rëndësishëm ndërmjet garancive të parashikuara nga ana e nenit 5 të Konventës. Pikërisht atë të rishikimit periodik të ligjshmërisë së heqjes së lirisë së një personi. Momenti për tu vënë re në këtë çështje është pikërisht ai që në vetvete, mbyllja e Z. Winterwerp në spital psikiatrik justifikohet për shkak të gjendjes së tij psikike në bazë të nenit 5 § 1 (e) dhe për këtë arsye Gjykata nuk konstatoi shkelje të këtij paragrafi. Por nga ana tjetër, ajo konstatoi shkelje të paragrafit 4 të nenit 5 të Konventës për shkak se kërkuesit nuk i ishte krijuar mundësia për të rishikuar vendimin për izolimin e tij<sup>1</sup>. Kjo sipas mendimit të Gjykatës është e domosdoshme për atë që kushtet që kanë legjitimuar fillimisht privimin e lirisë së personit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo është e vërtetë sidomos në rastin e të sëmurëve mendorë. Elementi tjetër që çoi në shkelje të këtij neni konsistonte në faktin se organet që vendosnin për zgjatjen e kësaj periudhe nuk kishin karakter gjyqësor dhe as procedura e ndjekur prej tyre në marrjen e vendimeve për kohëzgjatjen e heqjes së lirisë nuk kishte karakter gjyqësor<sup>2</sup>.

15. Kriteret e përpunuara nga Gjykata në këtë vendim janë referuar shpesh prej saj në çështje të mëvonshme duke i sqaruar edhe më tej ato. Në të gjitha këto çështje Gjykata ka qenë e detyruar të ritheksojë faktin që vendimi fillestar për heqje lirie është dhënë nga një gjykatë sipas një procedure të rregullt gjyqësore, nuk do të thotë se vendimet vijuese për zgjatjen e periudhës së heqjes së lirisë mund të jepen nga një organ që nuk përmbush kriteret e konceptit gjykatë<sup>3</sup>. Kujtojmë se përsa i përket çështjes konkrete, Gjykata vendosi shkelje të nenit 5 § 4 në këtë aspekt, pavarësisht se vendosi që nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 Konventës në lidhje me vendimin që kishte vendosur izolimin e kërkuesit në spital psikiatrik.

---

<sup>1</sup> Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të 18 qershorit 1971, në lidhje me çështjen *De Wilde, Ooms dhe Wersyp kundër Belgjikës*, ku Gjykata e sqaron këtë moment (sidomos § 76).

<sup>2</sup> Shih sidomos paragrafët 56 deri 64 të vendimit.

<sup>3</sup> Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Thyne*, *Wilson dhe Gunnell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, etj.